



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 03-02/2436/18
Nr. i faq. Broj stranica 03	Data Datum 15.08.2018
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të Nenit 11, paragrafi 1.1, Nenit 5, paragrafi 1, pika 1.5, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Nenit 18, paragrafët 4, 8 dhe 12, të Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe Nenit 19, paragrafi 11 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 15.08.2018 mori:

V E N D I M

- I. **Ekziston konflikt i interesit** në rastin e trajtuar me nr. AKK -03-02-821/18, për zyrtarin e lartë z. Memli Krasniqi, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht Nën-President i parë i Komitetit Olimpik të Kosovës.
- II. Agjencia e njofton Kryetarin e Kuvendit, dhe kërkon fillimin e procedurave ligjore ndaj tij.
- III. Agjencia do të kërkoj fillimin e procedurës për kundërvajtje nga Gjykata kompetente.
- IV. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në web faqen zyrtare të Agjencisë.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, z. Memli Krasniqi, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht Nën-President i parë i Komitetit Olimpik të Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

z. Memli Krasniqi, pozitën e deputetit e ushtron konform Ligjit Nr. 03/L-111 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, ndërsa pozitën e Nën-President të parë të Komitetit Olimpik të Kosovës e ushtron në bazë të statutit të Komitetit Olimpik të Kosovës, Komitet ky i cili

funksionon sipas dispozitave të Ligjit 2003/24 për Sport, Ligji Nr. 04/1-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për Sport. Komiteti Olimpik i Kosovës sipas dispozitave të ligjit për sportin gëzon statusin juridik të Organizatës Jo Qeveritare dhe qeveriset sipas Statutit të Komitetit Olimpik të Kosovës të miratuar më datë 24 Shkurt 2016 dhe dispozitave të Ligjit Nr. 04/1-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.

Zyrtari i lartë, sipas procedurës fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (AKK-DPK-03-02/1264/18). Më pas është organizuar një takim me zyrtarin e lartë për të diskutuar lidhur me situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.

Gjatë procedurës së trajtimit të rastit për konflikt interesi, Agjencia i ka dërguar shkresë paralajmëruese zyrtarit të lartë (AKK-DPK-03-02/1642/18), me të cilën është konstatuar se ushtrimi i funksionit Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht Nën-President i parë i Komitetit Olimpik të Kosovës është i ndaluar me Ligjin Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Neni 14, paragrafi 1, në të cilin shprehimisht thuhet:

“Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me to”.

Nga kjo del se, zyrtari i lartë z. Memli Krasniqi mund të jetë vetëm anëtar i organit drejtues në Komitetin Olimpik të Kosovës, duke përjashtuar funksionin që ushtron aktualisht në Bordin Ekzekutiv si Nën-President i Parë i Komitetit Olimpik të Kosovës, sipas Nenit 6 të Statutit të Komitetit Olimpik të Kosovës.

Nga zyrtari i lartë z. Memli Krasniqi është kërkuar të heq dorë nga njëri funksion brenda afatit ligjor, përndryshe Agjencia është e obliguar të veproj konform Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Pas kësaj, me kërkesë të z. Memli Krasniqi janë organizuar disa takime për të diskutuar lidhur me rastin. Gjatë këtyre takimeve zyrtari i lartë nuk e ka pranuar konstatimin e Agjencisë për gjendjen e konfliktit të interesit.

Përkundër afatit ligjor të dhënë nga Agjencia, zyrtari i lartë z. Memli Krasniqi nuk ka ndërmarrë veprime me qëllim të evitimit të gjendjes së konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në bazë të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, “zyrtari i lartë ka për detyrë të parandaloj dhe të zgjidhë vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tij të interesit”, Neni 8, paragrafi 1, të Ligjit Nr.06/L-011.

II. Bazuar në Nenin 22, paragrafi 10, të Ligjit (Nr.06/L-011), kur deputeti i Kuvendit ushtron aktivitet të papajtueshëm me këtë ligj, Agjencia e njofton Kryetarin e Kuvendit, dhe kërkon fillimin e procedurave ligjore ndaj tij.

III. Sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e funksionit Publik (Nr.06/L-011) Neni 23, paragrafi 1, çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, kur nuk paraqet vepër penale, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë sipas nën-paragrafit 1.1.

IV. Të gjitha Vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në web faqen zyrtare të Agjencisë, Neni 22, paragrafi 12.

Nga ajo që u tha në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit



Vendimi iu dërgohet:

- *Zyrtarit të lartë publik*
- *Drejtorit të DPK-së*
- *Z./znj. (zyrtari përgjegjës)*
- *Z./znj. (zyrtari ndihmës)*